



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo/ Republic of Kosovo**  
**Komuna Rahovec - Opštine Orahovac**

**Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë - Sektori për pronë**  
**Odeljenje za Geodeziju, Katastar, i Imovinu - Sektor za imovinu**

Datë/a	31.12.2024
Referencë/a	
Për/Za?To :	Z. Smajl Latifi, kryetar i Komunës së Rahovecit
CC:	Z. Fatmir Iska, nënkryetar i Komunës së Rahovecit
Përmes/Prekp/Through:	Drejtëpërdrejtë
Nga/Od/From :	Z. Afrim Oruqi, Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
Subjekt/Subekat/Subject:	Raporti vjetor i punës janar- dhjetor 2024

**RAPORTI VJETOR I PUNËS JANAR- DHJETOR 2024**



Fillimi i vitit të ri është karakterizuar me qasje në detyrat e reja dhe obligimet e mbetura nga viti paraprak. Në fillim të vitit 2024 kemi punuar në realizimin e detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuara nga kryetari i Komunës në përputhje me Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit dhe Planin e Punës për Vitin 2024.

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor të punës për të cilën po raportojmë, të tre sektorët e drejtorisë i kanë përfunduar këto punë:

Sektori:	Lëndët:	Shuma në €
Kadastër dhe Pronë	1276	27,000€
Gjeodezi	910	28,693€
Referenti	2,002+70 (L.Z.)	12,334€
<b>Totali</b>	<b>4,188+70 (L.Z.)</b>	<b>68,027.00€</b>

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor i kemi përfunduar këto punë:

- ④ Pranimi i aplikacioneve të qytetarëve dhe të gjeodetëve privat për ndarje të parcelave, bashkim të parcelave, regjistrim i pjesës së ndarjes, regjistrim të hipotekave, çregjistrim të hipotekave, shitblerje, trashëgimi, falje, ndërrim i paluajtshmërisë, ndarje e bashkësisë familjare etj.;
- ④ Kërkesa për certifikatat e pronës dhe kopje të planit;
- ④ Barazimi financiar me drejtorinë e financave për muajt janar – dhjetor të vitit 2024;
- ④ Pranimi i lëndëve për ndarje fizike, produkte si: koordinata, modifikime dhe punë tjera të cilat janë kryer nga sektori i gjeodetëve;
- ④ Kemi përgatitur materialin për dhënien e pronës me qira, interes i përgjithshëm, vendim për këmbim etj.;
- ④ Vlerësimi i punëtorëve për vitin 2023;
- ④ Sipas afatit, lëndët i kemi pranuar dhe aprovuar me kohë në intranet;
- ④ Përgjigje në kërkesat e personave juridik dhe fizik;
- ④ Me kërkesë të qytetarëve/grupeve të interesit (komuniteteve) kemi përgatitur material për mbledhje të kuvendit;
- ④ Me kërkesë të qytetarëve për falje të pronës private në pronë publike në të gjitha Zonat Kadastrale për hapje të rrugëve publike në interes të përgjithshëm, gjeodetët kanë dalë në terren dhe kemi përgatitur dokumentacionet e nevojshme për zhvillimin e këtyre procedurave;
- ④ Me kërkesë të kryetarit të Komunës, z. Smajl Latifi, drejtuar ministrive përkatëse për zhvillimin e procedurave për shpronësim të parcelave ku është pompa e derivateve në qytet dhe parcela ku operon për momentin kafeneja “Hardhia”, procesi ka përfunduar dhe prona tash më është në pronësi të komunës.
- ④ Dalje në terren sipas kërkesave të drejtorive përkatëse;
- ④ Kemi mbajtur takime të rregullta me Agjencinë Kadastrale të Kosovës;
- ④ Përgjigje në kërkesat e zyrës ligjore sipas nevojës për përfaqësime në procese gjyqësore;
- ④ Takim me përfaqësues të USAID-it për menaxhim të mirë të pronës;
- ④ Sipas legjislacionit në fuqi kemi përgatitur listën e veçantë dhe listën e përgjithshme të pronave, të cilat planifikojmë t’i japim me qira brenda vitit 2025; është në proces digitalizimi kadastral- vektorizimi i Zonave Kadastrale në nivel të komunës, operatori ka filluar që të i dorëzoj materialet e zonave kadastrale të vektorizuara dhe
- ④ Punë të tjera sipas kërkesave të palëve.

---

Me respekt,  
Afrim Oruqi

---

*Drejtore i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë*

**Komuna Rahovec**

Mob: +377 (0) 45 134 006 / Ctx: +381 (0) 3820045311

E-mail adresa: afrim.oruqi@rks-gov.net